



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.435/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Fikret Morina, kandidat për kryetar në Komunën e Mamushës, nga radhët e Subjektit Politik Mamusa Halk Hareketi, me seli në Mamushë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, për parregullsi gjatë ditës së votimit, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 9 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.435/2025, e datës 11.11.2025, e parashtruar nga Fikret Morina, kandidat për kryetar në Komunën e Mamushës, nga radhët e Subjektit Politik Mamusa Halk Hareketi, me seli në Mamushë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, për parregullsi gjatë ditës së votimit, raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 9 Nëntor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 11.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.435/2025, nga Fikret Morina, kandidat për kryetar në Komunën e Mamushës, nga radhët e Subjektit Politik Mamusa Halk Hareketi, në të cilën theksohet se ditën e votimit me 9 Nëntor, kanë dyshime për manipulim gjatë votimit, përkatësisht në vendvotimit 3201/02, disa fletëvotime të përdorura vula e KQZ-së ishte me ngjyrë të zezë, ndërkohë që në fletëvotimet e tjera ishin me ngjyrë blu. Tutje shtojnë se vëzhguesit kishin raportuar se gjatë qendrës së votimit kishin qarkulluar vazhdimisht persona të njëjtë, të cilët mund të kenë ndikuar drejtpërdrejtë në votues. Sipas të dhënave krahasuese me zgjedhjet e mëparshme, në këtë qendër u regjistrua një rritje e pazakontë e votave, kjo se bashku me ndryshim të ngjyrës së vulës, rrit dyshimet për një procedurë të manipulueshme, për shembull me metodën e njohur si “treni bullgar”. Kanë kërkuar nga PZAP të kryhet verifikimi i plotë mbi votat e administruara në vendvotimin me numër 3201/02, dhe nëse konstatohet ekzistenca e provave për manipulim ose “treni bullgar”, të deklarohen të pavlefshme të gjitha votat e vlefshme të kësaj qendre. Ankesës i ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, thekson se bazuar në nenin 101 të LZP-së Nr.08/L-228, Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Po ashtu bazuar në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 për Votimin, Numërimin e Vendvotimit dhe Menaxhimin e Vendvotimit përcaktohet në mënyrë të detajuar mbarëvajtja dhe ecuria, obligimet në vendvotim. Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit vlejné procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votave në një VV apo QV. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Tutje theksojnë se pretendimet e palës ankuese janë të përgjithshme, të mbështetura pa asnjë provë, jo të konkretizuara, të pa specifikuar për parregullsitë, nga kush është ushtruar kanosje, a është lajmëruar rasti në KKZ ose në organet e rendit, e nuk ka bashkangjitur asnjë deklaratë të ndonjë dëshmitari ose të ndonjë komisioneri të subjektit politik të palës ankuese. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkangjitur prova relevante, siç janë Librit i votimit, ndonjë mostër të fletëvotimit të vulosur më ngjyrë të zezë etj. Tutje, kanë shtuar se i gjithë materiali zgjedhor, duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë momentalisht gjenden në QKN të komunës së Mamushës, mirëpo pas përfundimit të gjitha procesit të punës së QKN-së i njëjti material zgjedhor do të dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve – QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e pabazuar

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga Fikret Morina, kandidat për kryetar në Komunën e Mamushës, nga radhët e Subjektit Politik Mamusa Halk Hareketi, të paraqitur kundër KQZ-së, me pretendimet se në vendvotimin 3201/02, ka pasur manipulime me fletëvotime ashtu që në disa fletëvotime vula ka qenë me ngjyrë të zezë ndërsa në fletëvotimet e tjera vula ka qenë me ngjyrë të kaltër, Paneli vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë se ka pasur manipulim me fletëvotime specifikisht me vulën e vendosur në fletëvotim, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindese me të cilat mund të dëshmonte se ka ndodhur shkeljet e pretenduara, përkatësisht nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi andaj ankuesi nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani

për tani mbeten vetëm ne suaza te dyshimit nga se këto pretendime nuk janë vërtetuar me prova konkrete.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës, nuk mund të vërtetohet se ne disa fletëvotime të përdorura vula e KQZ-së ishte me ngjyrë të zezë, ndërkohë që në fletëvotimet e tjera ishin me ngjyrë blu, apo se persona të paautorizuar kanë qëndruar në hapësirat e vendvotimit pothuajse gjatë gjithë ditës duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Po ashtu, Paneli ka vlerësuar se lidhur me këtë pretendim nuk ka pasur asnjë vërejtje apo ankesë në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, i cili nuk ka pranuar asnjë ankesë nga kjo qendër e votimit nga personat përgjegjës, nga menaxheri i qendrës së votimi apo nga anëtarët e Këshillit të vendvotimeve e as nga vëzhguesit e kësaj qendre përkatësisht vendvotimeve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Kështu që Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, konstatoi se dëshmitë e ofruara nuk janë të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Amdaj në rastin konkret të provuarit e pretendimeve ankimore te parashtruesit te ankesës se disa fletëvotime të përdorura vula e KQZ-së ishte me ngjyrë të zezë, ndërkohë që në fletëvotimet e tjera ishin me ngjyrë blu apo që disa persona të paautorizuar kanë qëndruar në hapësirat e vendvotimit pothuajse gjatë gjithë ditës duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, paraqiten si pretendime hipotetike dhe nuk është arrite te vërtetohet me prova e ofruara nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pa bazuar.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nënin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.435/2025 më datën 12.11.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.